



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1275/4 prot.

Datë 10.06.2025

V E N D I M
Nr. 756/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.06.2025 me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000 (tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K21511002I dhe adresë: Rruga “Shefqet Musaraj” banesa nr.17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.
Adresa: Lagjja Nr.4 Rr. “Fetah Bllaca”, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të 3(tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.05.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

II.2. Në datën 19.05.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojca për një ndryshim të dokumentave të tenderit me objekt: “Kite dhe reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, REF-47110-05-06-2025, dhe ndryshimi i afatit për zhvillimin e tenderit datë 29.05.2025

II.3. Në datën 19.05.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5325 dhe me nr. 1275 prot., datë 19.05.2025 e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i kriterëve të veçanta të procedurës së prokurimit të sipërcituar për sa më poshtë

- Ne shtojcen 8 ,pika 2.4.1 ‘Kriteret e Veçanta të Kualifikimit’ autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatori ekonomik te paraqese autorizim prodhuesi: ‘Autorizim nga

Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi për shitje, tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara objekt i kontratës. (Dokumentat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara)' Ne specifikimet teknike të kërkuara për keto artikuj me siper, AK nuk ka vendosur specifikime teknike të produkteve apo llojin e testimit që duhet të kryejë produkti, përveçse ka dhënë emertime të brandeve të caktuara të cilat i gjeni në link-un përkatës sipas numrit të cituar.

Përveç kësaj Operatorët Ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender nuk mund të ofertojnë produkte alternative sipas nevojë së testimit për atë kohë sa produkti nuk është detajuar në specifikime apo në testim.

Produktet janë të Kompanisë :

21- Liofilchem

82- Cmp Srl

84-Liofilchem

83- Liofilchem

95-Certest (në emertim të produktit gjendet dhe emri i kompanisë prodhuese Cer-test)

112-114 Xylem.

Si përfundim KERKOJME NGA AK:

- 1. SPECIFIKIME TEKNIKE PËR ARTIKUJT NR. 21,82,83,84,95,112,113,114 sipas funksionit dhe qëllimit të përdorimit dhe jo emertime sipas markave që përmendëm me siper.*
- 2. Në qoftëse AK kërkon produktet e sipërcituara, KERKOJME TË HIQEN AUTORIZIMET, në mënyrë që të bëhet një konkurrence e hapur.*

II.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Me shkresën nr.240/7, datë 03.06.2025, protokolluar me tonën nr.1275/1, datë 09.06.2025, autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetsor Durrës, na informon se nuk është njohur në kohë me ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vazhduar me hapjen e procedurës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me hapat e mëtejshëm proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për zhvillimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetsor Durrës me nr.240/7, datë 03.06.2025, protokolluar me tonën nr.1275/1, datë 09.06.2025,, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi i ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5325 dhe me nr. 1275 prot., datë 19.05.2025 e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, duke informuar se: “[...] se nuk është njohur në kohë me ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vazhduar me hapjen e procedurës....”, Komisioni vëren se;

III.1.2. Në nenin 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
 - b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
 - d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni. 4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit dhe publikon njoftimin e anulimit. 5. Shfuqizuar”.

III.1.3. Në nenin 100, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.4. Nisur nga veprimet e autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetsor Durrës, KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës, duke hapur ofertat, sipas informacionit të dërguar me shkresën nr. 240/7 prot., datë

03.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1275/1 prot, datë 09.06.2025, pa nxjerrë KPP një vendim përfundimtar për shqyrtimin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5325 dhe me nr. 1275 prot., datë 19.05.2025 të operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK për këtë procedurë prokurimi, si dhe pa nxjerrë KPP një vendim përfundimtar që lejon autoritetin kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi, pasi kjo ankesë e operatorit ekonomik ankimues ishte akoma në shqyrtim nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Përmes këtij veprimi, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale, të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e nenin 100, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor duhej të mbante të pezulluar këtë procedurë prokurimi deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK. Lidhur me këtë fakt, KPP gjykon, se ndodhemi para asnjërës prej arsyeve që parashikon neni 98 i lex specialis për anulimin e procedurës së prokurimit. Referuar sistemit të prokurimit elektronik dhe informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme objekt ankimi, duke e hequr procedurën nga pezullimi dhe duke vijuar me fazën e hapjes së ofertave, ndërkohë që Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka nxjerrë një vendim lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK. Në këtë rast, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedural, duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës, duke e hequr nga pezullimi atë, pa nxjerrë KPP një vendim që lejon vijimin e saj, duke çënuar interesat e ligjshëm të operatorit ekonomik të interesuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Sa më sipër, KPP konstaton, se jemi para veprimeve procedurale të gabuara, duke vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pa pritur një vendim të KPP, që lejon autoritetin kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës, veprime të cilat kanë çënuar interesat e ligjshëm të operatorit ekonomik ankimues dhe ndodhemi para rasis për anulimin e procedurës së prokurimit.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK se “*Ne shtojcen 8 ,pika 2.4.1 ‘Kriteret e Veçanta të Kualifikimit’ autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatori ekonomik te paraqese autorizim prodhuesi: ‘Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi për shitje,tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara objekt i kontratës.(Dokumentat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara)’ Ne specifikimet teknike te kerkuara per keto artikuj me siper,*

AK nuk ka vendosur specifikime teknike te produkteve apo llojin e testimit qe duhet te kryeje produkti, pervecse ka dhene emertime te brandeve te caktuara te cilat i gjeni ne link-un perkates sipas numrit te cituar.

Pavec kesaj Operatoret Ekonomike te interesuar per te marre pjese ne tender nuk mund te ofertojne produkte alternative sipas nevojje se testimit per aq kohe sa produkti nuk eshte detajuar ne specifikime apo ne testim.

Produktet jane te Kompanise :

21- Liofilchem

82- Cmp Srl

84-Liofilchem

83- Liofilchem

95-Certest (ne emertim te produktit gjendet dhe emri i kompanise prodhuese Cer-test)

112-114 Xylem.

Si perfundim KERKOJME NGA AK:

SPECIFIKIME TEKNIKE PER ARTIKUJT NR. 21,82,83,84,95,112,113,114 sipas funksionit dhe qellimit te perdorimit dhe jo emertime sipas markave qe permendem me siper.”,

Komisioni i prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

21	Enterosistem	Paketa te mbyllura hermetikisht
81	Test I shpejte HIV 1+HIV 2	Test i shpejtë imunokromatografik ,një përdorim paketim individual
82	Urogen Ëell D-one	Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht
83	Urine system chrom	Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht
84	Integral system yeasts plus	Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht teste
95	Cer Test Campylobakterr	Test I shpejte paketim individual
112	Kite per spektrofotometer UV6600-VIS NH4	25test/kutia
113	Kite per spektrofotometerUV6600-VIS NO 2	25test/kutia
114	Kite per spektrofotometerUV6600-VIS Fortesi Totale	25test/kuti

III.2.2. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa

sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktorë në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues

i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj" në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: "Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim". Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin,

markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Evropian vs. Mbretëria e Holandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.2.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe i barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike, duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, dhe në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se kriteret dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar. Në rastin konkret lidhur me pretendimet e ankimesit dhe pas verifikimit të përmbajtjes së specifikimeve teknike konkretisht për artikujt nr.21 “Enterosistem”, nr.82 “Urogen Ëell D-one”, nr.3 “Urine system chrom”, nr.84 “Integral system yeasts plus”, nr.95 “Cer Test Campylobakterr” nr.112 “Kite

per spektrofotometer UV6600-VIS NH4”, nr. 113 “Kite per spektrofotometerUV6600-VIS NO 2” dhe nr.114 “Kite per spektrofotometerUV6600-VIS Fortesi Totale”, KPP gjykon se për specifikimet teknike të këtyre artikujve autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për përcakimin edhe të fjalës “ose ekuivalente” në kuptim të asaj çfarë parashikon dhe neni 4 “Përkufizime” pika 7 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, mbi ekuivalencën ku përcaktohet se: “7. “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK se “*Ne qoftese AK kerkon produktet e sipercituara, kerkojme te hiqen autorizimet, ne menyre qe te behet nje konkurrence e hapur.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të mos e marrë në shqyrtim këtë pretendim për sa kohë që KPP në këtë vendim ka vendosur pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me specifikimet teknike të artikujve objekt ankimi dhe për të cilat në DST nga ana e autoritetit kontraktor në shtojcën 8 të kritereve të veçanta për kualifikim kërkohet Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi për shitje, tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara objekt i kontratës (Dokumentat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara).

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit me “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000 (tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

